



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P 54/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave skualifikimin e ofertës ekonomike “Nazeri 2000” shpk dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Kumria 1” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr REF-77112-10-29-2020 me objekt “*Shërbimi privat i sigurisë fizike të Drejtorise Sherbimit Spitalor Librazhd*”- *Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj*” me fond 12,995,672.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd

**Ankimues:** “Nazeri 2000” shpk  
Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd  
Rruga “Jahup Bicaku”

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.10.2020, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr REF-77112-10-29-2020 me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd”- Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 24 muaj” me fond 12,995,672.00 Lekë

pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd

II.2. Në datën 03.12.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.12.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Kumria 1	12.635.673,52	kualifikuar
Nazeri -2000	12.635.673,52	skualifikuar

II.4. Në datën 14.12.2020 operatori ekonomik “Kumria 1 ” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

*1. Nuk plotëson kërkesën për kualifikim kriterin 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.4, pasi nga dokumentacioni :Akt-administrativ me titull “Performanca e subjektit” viti 2020, lëshuar nga DV e Policisë Elbasan, të paraqitur nga ana juaj nëpërmjet SPE, nuk arrini të provoni se keni grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me nga 2 punonjës për çdo turn, sikurse është kërkuar në DST, duke mos plotësuar kërkesat e kriterëve të veçanta të kualifikimit. 2. Nuk plotëson kërkesën për kualifikim kriterin 2.3 kapaciteti teknik pika 2.3.4, pasi nga dokumentacioni :Akt-administrativ me titull “Performanca e subjektit” viti 2020, lëshuar nga DPQ Elbasan, të paraqitur nga ana juaj nëpërmjet SPE, nuk arrini të provoni që “të mos ketë marrë masë administrative për operatorin ekonomik (Titullar dhe drejtues teknik) për vitet 2018- 2019”, pasi “Performanca e subjektit”, nr.7169 prot ,date 10.11.2020, nuk ka të përcaktuar shprehimisht periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni referuar kriterit të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Pra nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet vertetim i vlefshëm*

II. 5 Në datën 16.12.2020 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

*Nëpërmjet kësaj ankese duam tju bëjmë prezent një problem që konsiston me shkeljet e kryera nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd” për procedurën e prokurimit organizuar më datë 03.12.2020 me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd” –Marrëveshje Kuadër”- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 24 muaj si më poshtë:*

*Nga ana e KVO në datën 10.12.2020 në mënyrë elektronike është dërguar njoftim mbi klasifikimin e Shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi:*

*Sipas këtij klasifikimi rezulton i skualifikuar shoqëria jonë me pretendimin se :*

Nuk plotëson kërkesën për kualifikim kriterin 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.4, pasi nga dokumentacioni :Akt-administrativ me titull "Performanca e subjektit" viti 2020, lëshuar nga DV e Policisë Elbasan, të paraqitur nga ana juaj nëpërmjet SPE, nuk arrini të provoni se keni grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me nga 2 punonjës për çdo turn, sikurse është kërkuar në DST, duke mos plotësuar kërkesat e kriterëve të veçanta të kualifikimit. 2. Nuk plotëson kërkesën për kualifikim kriterin 2.3 kapaciteti teknik pika 2.3.4, pasi nga dokumentacioni :Akt-administrativ me titull "Performanca e subjektit" viti 2020, lëshuar nga DPQ Elbasan, të paraqitur nga ana juaj nëpërmjet SPE, nuk arrini të provoni që "të mos ketë marrë masë administrative për operatorin ekonomik (Titullar dhe drejtues teknik) për vitet 2018- 2019", pasi "Performanca e subjektit", nr. 7169 prot ,date 10.11.2020, nuk ka të përcaktuar shprehimisht periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni referuar kriterit të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Pra nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet vertetim i vlefshëm

Autoriteti Kontraktor duhe të kualifikojë shoqërinë tonë pasi arsyeja e skualifikimit nuk qëndron është e njëanshme dhe është e padrejtë pasi nga ana jonë janë paraqitur të gjithë dokumentat e kërkuar ne dst të cilat provojnë përmbushjen e kriterëve të kërkuara.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka kërkuar Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me afat brenda një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të certifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës shërbimi; -Të ketë qendër kontrolli me 5(pesë) operator dhe grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me 2 (dy) punonjës për çdo turn; - Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019.(të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të); Ky vërtetim duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin pozitiv për operatorin ekonomik.

-Së pari , Autoriteti Kontraktor duhet të kualifikojë shoqërinë tonë pasi bazuar ne Udhëzimin Ministrisë të Brëndsheëm nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" kreu V, pika 13 sanksionohet: Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me perbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve. Në vërtetimin e Performances nr. 7169 prot. date 10.11.2020 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, vërtetohet se Shoqëria NAZERI 2000 ka 6 (gjashtë) punonjës grup të gatshëm, dhe në këtë rast matematika është e thjeshtë: 6 (gjashtë) punonjës grup i gatshëm / 2 (dy) punonjës për çdo turn =3 turne, pra Turni i I +Turni i II + Turni i III (24 ore).

Në datën 10.12.2020 ju drejtuam me shkresë zyrtare Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan në lidhje me grupin e gatshëm të Shoqërisë sonë dhe në datën 15.12.2020, DVP Elbasan na ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8041 prot ku theksohet se "Grupi i verifikimit të sinjaleve (Grupi i gatshëm), i shoqërisë sonë, kryen shërbim 24 ore me tre turne të ndara Turni i I 2 punonjës, Turni i II 2 punonjës dhe Turni i III 2 punonjës". Grupi i verifikimit të sinjaleve shërben për verifikimin e sistemeve të sinjaleve të vendosura në objektet të cilat jeni kontraktor si dhe mbështet dhe nderhynë ne objektet të cilat ju keni në ruajtje me vendroje në rastet kur kane problem dhe kerkohet nga punonjësit te cilet jane ne sherbim.

Sa me siper Autoriteti Kontraktor duhet te kualifikojë shoqërinë tonë pasi arsyeja e skualifikimit nuk qëndron dhe është e padrejtë.

- . Se dyti, Autoriteti Kontraktor duhet te kualifikoje shoqerine tone pasi shoqeria jone ka paraqitur ne SPE

1. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 7169 prot. date 10.11.2020,

2. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 3181 prot. date 29.05.2020,

3. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 2202 prot date 27.03.2019

te cilat japin informacion per vitin 2018, 2019, 2020. Ne keto Vertetime Performance shprehet qartesisht qe shoqeria NAZERI 2000 nuk ka masa adminisrauve te dhëna nga DVP Elbasan për vitin 2018, 2019 dhe 2020. Në këto vertetime Performace shprehet qartësisht qe Shoqëria Nazeri-2000 nuk ka masa administrative të dhëna nga DVP Elbasan për vitin 2018, 2019, 2020.

Sa me siper nga dokumentacioni I dorezuar ne SPE provohet qartesisht se shoqeria jone ka grup te gatshem 24 ore (tre turne) me 2 (dy) punonjës për çdo turn si dhe nga Vertetimet Performances se paraqitura rezulton se shoqeria nuk ka marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019. (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të). Shoqeria jone e ka permbushur tërësisht kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe si I tille ky pretendimin nuk qendron dhe Kompania NAZERI 200 duhet te kualifikohet.

-Se treti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine Kumria I pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.2. Il pasi bilancet e paraqitura në vitin 2017-2018-2019 nuk kanë të bashkëngjitur raportin e auditimit për pasqyrat financiare Sikurse parashikohet ne nenin 41 te ligjit 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor. organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe tt kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Te njejtin qendrim mban edhe KPP me vendime te ngjashme nr. 330/2020 date 20.08.2020 ku shprehet se: ...."III. 15. 7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar prej operatorëve ekonomikë të sipërpërmendur, nga ku referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga ofertuesi "Oktapus" shpk për vitet 2016, 2017 dhe 2018 konstatohet se kv ofertues i përmbush kushtet për totalin e aktiveve të bilancit dhe shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike, prandaj ka patur detyrimin për të paraqitur raportin e ekspertit kontabël të miratuar për bilancet e viteve 2016, 2017 dhe 2018, sikurse parashikohet në bazën ligjore të sipërpërmendur, ndërsa operatori ekonomik "Ankonda Security" shpk nga shqyrtimi i pasqyrave fianciare për vitet 2016, 2017 dhe 2018, muk i përmbush kushtet për totalin e aktiveve të bilancit dhe shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike. prandaj muk ka patur detyrimin për të paraqitur raportin e ekspertit kontabël të miratuar për bilancet e viteve 2016, 2017 dhe 2018, sikurse parashikohet në bazën ligjore të sipërpërmendur. Në këto kushte KPP gjykon se operatori ekonomik "Oktapus" shpk nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

-Se katerti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine Kumria l pasi nuk ploteson nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst, 2.3 Kapaciteti teknik 2.3.3 pasi Akti i miratimit i dorëzuar nga kjo shoqëri nuk ka te bashkëngjitur listeën e dokumentacionit dhe paisjeve ashtu si përcaktohet ne Udhezimin e Ministrit te Brëndshëm nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" KREU VII, germa D Qendra e Kontrollit pika 5 citojme: Miratimi Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në do dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve.

*Përfundimisht nga Argumentimi I berë sa më sipër kërkohet nga ana e Autoritetit Kontraktor të bëhet kualifikimi I Shoqërisë sonë pasi arsyet e skualifikimit nuk qëndrojnë, pra skualifikimi është bërë në mënyrë të njëanshme dhe të padrejtë dhe të skualifikohet shoqëria Kumria I pasi nuk përmbush kërkesat e Autoritetit Kontraktor.*

II.5. Me shkresën nr.54/17 prot datë 21.12.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues lidhur me mospranimin e ankesës;

II.6. Në datën 28.12.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 54/20 prot 06.01.2021 protokolluar me tonën me nr.1802 /2 prot datë 07.01.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1.. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomikë “*Nazeri 2000*” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyen se: [...]

*, Autoriteti Kontraktor duhet te kualifikoje shoqerine tone pasi shoqeria jone ka paraqitur ne SPE*

*1. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 7169 prot. date 10.11.2020,*

*2. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 3181 prot. date 29.05.2020,*

*3. Vertetimin e Performances nga DVP Elbasan me nr. 2202 prot date 27.03.2019*

*te cilat japin informacion per vitin 2018, 2019, 2020. Në keto Vërtetime Performance shprehet qartesisht që shoqëria shoqëria NAZERI 2000 nuk ka masa administrative të dhëna nga DVP Elbasan për vitin 2018, 2019 dhe 2020. Në këto vertetime Performace shprehet qartësisht që Shoqëria Nazeri-2000 nuk ka masa administrative të dhëna nga DVP Elbasan për vitin 2018, 2019, 2020.*

*Sa me siper nga dokumentacioni I dorezuar ne SPE provohet qartesisht se shoqeria jone ka grup te gatshem 24 ore (tre turne) me 2 (dy) punonjës për çdo turn si dhe nga Vertetimet Performances se paraqitura rezulton se shoqeria nuk ka marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019. (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të). Shoqeria jone e ka përmbushur tërsisht kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe si I tille ky pretendimin nuk qëndron dhe Kompania NAZERI 200 duhet te kualifikohet. [...].Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 të modifikuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

- Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim performace nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me afat brenda një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për:  
-Lista emërore e punonjësve të çertifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës shërbimi; -Të ketë qendër kontrolli me 5(pesë) operator dhe grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me 2 (dy) punonjës për çdo turn; - Të mosë ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019.(të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të); Ky vërtetim duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin pozitiv për operatorin ekonomik.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatorët ekonomikë “Nazeri 2000” shpk, kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

*Vërtetim Performance për subjektin “Nazeri 2000” shpk, kategoria 1.3.A , lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me Nr. 7169 prot, datë 10.11.2020. Ku përcaktohet se ky subjekt ka të pasqyruara në informacionin e vërtetimit se “ nga kontrollet e ushtruara nga DVP gjatë ushtrimit të aktivitetit masat administrative të dhëna nga DVP për vitet 2020. Ngjarje të ndodhura nuk ka,masa administrative të dhëna nga DVP nuk ka.*

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”.

III.1.4. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Në nenin 19 “Mbikëqyrja e Veprimtarisë së SHPSF-ve” të Ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, përcaktohet shprehimisht: “Mbikëqyrja e veprimtarisë së SHPSF-ve i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohet legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

III.1.7. Në nenin 20 “Kompetencat Mbikëqyrëse”, të Ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, përcaktohet shprehimisht: 1. Strukturat e Policisë së Shtetit kanë këto kompetenca për mbikëqyrjen e veprimtarisë së SHPSF-së: a) kryejnë monitorimin, nëpërmjet dokumentacionit, për aktivitetin e shoqërive të sigurisë fizike; b) kryejnë inspektime për veprimtarinë e shoqërive të sigurisë fizike; c) kryejnë inspektime për mënyrën e kryerjes së detyrës nga punonjësit e këtij shërbimi; ç) kryejnë inspektime për kriteret e mbajtjes dhe përdorimit të armëve, sipas legjislacionit në fuqi; d) kryejnë inspektime për mbajtjen e uniformës, mjeteve lëvizëse, si dhe mjeteve të tjera në përdorim, sipas përcaktimeve në këtë ligj; dh) bëjnë identifikimin e shkeljeve të rregullave të shërbimit, mbajnë procesverbal konstatimi, ndjekin procedurat për marrjen e masave administrative, vendosin gjoba në vend.

III.1.8. Në Udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funkionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 11 dhe 13 është parashikuar:

11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me:

a) roje objekti për ruajtjen fizike;

b) truproje për ruajtjen e personave;



- c) sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;
- e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- f) përgjegjës shërbimi;
- g) punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;
- h) punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;
- i) shoqërues i qenit të shërbimit.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

III.1.9. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46, pika 1, gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: "[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]".

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, kriterit të përcaktuar në DST për dorëzimin nga operatorët ekonomikë të vërtetimit të performancës i cili duhet të jetë i lëshuar pas muajt tetor 2020 dhe në përmbajtje të të cilit "jepet informacion që nuk duhet te kete masa administrative, gjoba, verejtje sipas percaktimeve te ligjit 75\2014 per sherbimin privat te sigurise fizike dhe udhezimit te ministrit te brendshem nr 130 date 05.03.2018 per funksionimin e sherbimit privat te sigurise per vitin 2018 e ne vazhdim", nga verifikimet e kryera në SPE lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik "Nazeri 2000" shpk për plotësimin e kriterit të mësipërcituar, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik shpk nuk e përmbush kriterin e parashikuar nga autoriteti kontraktor pasi Vërtetimi i Performancës Nr. 7169 prot, datë 10.11.2020, në përmbajtjen e tij pasqyron se subjekti "Nazeri 2000" shpk nga kontrollat e ushtruara nga DVP gjatë ushtrimit të aktivitetit masat administrative të dhëna nga DVP për vitin

2020 e në vazhdim nuk ka, nuk pasqyrohet nëse operatori ekonomik ka patur masa administrative nga viti 2018 e në vazhdim, ashtu sikurse është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Nga sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërcituar ka paraqitur dokumentacionin konkretisht vërtetimet e performancës të lëshuar nga Drejtoria Vendore Policisë Elbasan për subjektin “Nazeri 2000” shpk me Nr. 2202 prot, datë 27.03.2019, Nr. 3181 prot, datë 29.05.2020, dhe Nr. 7169 prot, datë 10.11.2020, nga verifikimi i këtij dokumentacioni rezulton se operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk nuk ka arritur të përmbush kriterin për kualifikim të parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi konkretisht nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që të paraqitet nga operatorët ekonomik pjesëmarrës vërtetimi i performancës me afat brenda një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën duhet të pasqyrohen ndër të tjera edhe se operatorët ekonomik të mos kenë marrë masa administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019. (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të), ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërcituar rezulton se vërtetimet e performancës të paraqitura nga operatori ekonomik “Nazeri 2000”, nuk janë brënda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit konkretisht brënda një muaj nga dita e hapjes së ofertave. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Përsa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, për vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, mbas tetorit për këtë operator ekonomik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se këto dokumenta nuk japin informacion të lidhur me faktin se ky operator ekonomik gjatë aktivitetit të tij dhe konkretisht gjatë vitit 2018- e në vazhdim të mos ketë marrë masa administrative. Nga sa më sipër, si dhe duke patur parasysh kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik i më sipërcituar nuk e ka arritur të vërtetojë, kërkesën e autoritetit kontraktor pasi për periudhën 2018 e në vazhdim nuk pasqyrohet në vërtetimet e performancës nëse kanë masa administrative nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan. Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk

ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. mbi ofertat e paraqitura nga operatori ekonomik “Kumria 1” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë :

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr REF-77112-10-29-2020 me objekt *“Shërbimi privat i sigurisë fizike të Drejtorisë Sherbimit Spitalor Librazhd”- Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”* me fond 12,995,672.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1802 Protokoli, Datë 28.12.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**